

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Shqipe Qerimi, kryetare e kolegjit, gjyqtarët Hashim Çollaku dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Hysni Ismaili, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve, R.S. dhe V.Y., që të dy nga Prishtina, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë truporë nga neni 153 par 1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK, dhe B.B., nga fshati..., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë truporë nga neni 153 par 1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK, duke vendosur sipas ankesës Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4355/2012, të datës 25.04.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me 07.06.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4355/2012, të datës 25.04.2016, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4355/2012, të datës 25.04.2016:

- të akuzuarit R.S. dhe V.Y., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë truporë nga neni 153 par 1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK, janë liruar nga akuza në kuptim të nenit 364 par 1 pika 1.3 të KPPK, sepse nuk është provuar se kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar,

Shpenzimet e procedurës penale për këtë pikë të aktgjykimit kanë rënë në shpenzimet buxhetore të gjykatës.

- I akuzuari B.B., është shpallur fajtorë për shkak të veprës penale, lëndimi i lehtë truporë nga neni 153 par 1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, i dëmtuari është udhëzuar në kontestin e rregullt civilo juridik.

Është obliguar i akuzuari, që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka ushtruar ankesë i Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe shkeljes së ligjit penal, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë me shkresën PPA/II.nr.754/2016, të datës 01.06.2016, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ka propozuar që e njëjta të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar, të ndryshohet dhe të akuzuarit R.S. dhe V.Y. të shpallen fajtorë dhe të gjykoen sipas ligjit, ose që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, nuk është e bazuar

Sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ankimohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar se shkeljet konsistojnë në kuptim të nenit 383 par 1 pika 1.1 të KPPK, sepse në arsyetimin e paraqitur lidhur me dispozitivin e aktgjykimit, kemi paqartësi dhe kundërshtim mes tyre, pasi që arsyetimi nuk përmban arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtar, andaj, aktgjykimi si i tillë është i pa pranueshëm.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas ankesës së prokurorisë, sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 394 par.1 pika 1.1 të KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk përmban shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, për të cilat pretendohet në ankesë, sepse arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar, është i qarët, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten dhe me arsyet lidhur me faktet vendimtare, sepse në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur të njëjtit i ka liruar nga akuza për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë truporë nga neni 153 par 1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK, andaj, pasi që aktgjykimi është përpiluar konform dispozitës ligjore nga neni 370 të KPPK, i njëjti si i tillë është i pranueshëm për kolegjin e kësaj gjykate, dhe ka besueshmërinë e duhur juridike dhe ligjore.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke pretenduar se gjykata e shkallës së parë, nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në raport me të akuzuarit R.S. dhe V.Y., duke mos e vlerësuar në mënyrë të drejtë dëshminë e të dëmtuarit-dëshmitarit B.H., i cili ka përshkruar momentin e fillimit të sjelljes agresive me fjalë të rënda dhe një distance të afërt me të akuzuarin R.S., i cili thekson se e ka goditur me grusht në pjesën e mjekrës në anën e majtë dhe nga mbrapa i goditur nga të akuzuarit B.B., F.K., dhe V.Y.. Kjo gjendje faktike vërtetohet

edhe nga dëshmitë e dëshmitarit E.B., M.R., si dhe nga CD-kamera e sigurisë e vendosur në parlament, nga e cila shihet momenti kur ka filluar biseda dhe incidenti, dhe përgatitja e të akuzuarit R.S. për sulm në drejtim të dëmtuarit B.H., që vërehet edhe nga foto-dokumentacioni nga shkresat e lëndës nën shifrën 46-50, si dhe rrëmuja e krijuar pas kësaj rrahje. Edhe nga ekspertiza mjeko-ligjore e dt.03.08.2012, vërtetohet gjendja faktike si dhe lëndimi i të dëmtuarit, andaj, që të gjitha këto vërtetojnë se në veprimet e të akuzuarve konsistojnë elementet qenësore të veprës penale e cila u vihet në barrë të akuzuarve.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e prokurorisë, aktgjykimin e ankimuar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim që gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, kur të akuzuarit R.S. dhe V.Y., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë truporë nga neni 153 par 1 pika 4 lidhur me nenin 23 të KPK, i ka liruar nga akuza në kuptim të nenit 364 par 1 pika 1.3 të KPPK, sepse nuk është provuar se të njëjtit kanë kryer veprën penale e cila u vihet në barrë, e kjo rezulton nga deklaratat e të akuzuarve, dëshmitarit E.B., i cili thekson se ditën kritike pasi që ka qenë në kryerjen e detyrës në zyrën e vet në ndërtesën e Parlamentit të Republikës së Kosovës, ka marrë informacione se te dera e hyrjes së deputetëve është një fjalosje, kur ka zbritur poshtë nuk ka vërejtur asgjë, mirëpo nga zyra e recepsionistit në brendi të ndërtesës së Parlamentit, ka vërejtur një përleshje, ndërsa me të arritur në vendngjarje ka vërejtur B.H. të shtrirë në tokë duke tentuar që të ngritët, ndërsa R.S. dhe F.K. kanë qenë duke e sulmuar me grushta, dhe pasi që kam ndërhy i kam kapur që të dy dhe i kam larguar, kurse V.Y. e ka patur këmbën afër B.H., por deklaratat e dëshmitarit E.B., është kontradiktore dhe jo e vërtet që të njëjtës ti besohet, ngase në pyetjet shitesë ka përshkruar se nuk e kam vërejtur kush e ka goditur B.H., a e ka goditur i akuzuari R.S. të njëjtin nuk a kam parë. Gjithashtu edhe nga deklaratat e dëshmitarit M.R., si dhe dëshmitarit L.B., nuk vërtetohet që të akuzuarit ta kenë goditur të dëmtuarin, e kjo materializohet edhe me provat materiale në shkresat e lëndës, sikurse që janë CD-ja nr.1, video-incizimet e CD-së me nr.2, CD-nr.3 e TV NN, e gjithashtu edhe nga foto-dokumentacioni nga shkresat e lëndës, nuk mund të vërtetohet që të akuzuarit R.S. dhe V.Y., kanë kryer veprën penale e cila u vihet në barrë, andaj, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur të akuzuarit i ka liruar nga akuza pasi që nuk është provuar se e kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Sipas ankesës së prokurorisë, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, ankimohet për shkak të shkeljeve të ligjit penal, sepse gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar dëshminë e dëshmitarit-të dëmtuarit B.H., incizimet, foto-dokumentacionin, nga të cilat vërtetohet se sulmi ka filluar në mes të akuzuarit R.S. me të dëmtuarin B.H., e më pas është goditur i dëmtuari nga i akuzuari B.B. si dhe i akuzuari F.K., si dhe i akuzuari V.Y.. Po të ishte vërtetuar gjendja faktike në mënyrë të drejtë dhe të plotë, me siguri që edhe të akuzuarit R.S. dhe V.Y., do të ishin shpallë fajtorë dhe do të ishin dënuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së prokurorisë, shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim, se nga ana e gjykatës së shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar nuk janë bërë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, andaj, aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet as në shkeljet e ligjit penal, sepse gjykata e shkallës së parë e ka vlerësuar aktgjykimin në kuptim të nenit

385 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim që në këtë çështje penale sa u përket të akuzuarve R.S. dhe V.Y., gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë e ka zbatuar ligjin e aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, ka vepruar në kuadër të kompetencës ligjore, andaj, drejtë ka vendosur kur të akuzuarit në mungesë të provave i ka liruar nga akuzat, andaj, aktgjykimi është i pranueshëm edhe për kolegjin e kësaj gjykate.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1. nr.711/2016 të datës 07.06.2016

Bashkëpunëtori profesional
Hysni Ismaili

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetare e kolegjit
Shqipe Qerimi

Rasim Rasimi